



Prishtinë, 01 korrik 2024
Kodi i ZRRE-së: V_2225_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2554_05_24** i datës 29.05.2024;
- Ankesa e konsumatorit e datës 12.06.2024.

në seancën e mbajtur më datë 01 korrik 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e konsumatorit **A.B** nga Komuna e Prishtinës, e parashtruar ndaj vendimit të DMK-së;
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2554_04_24 i datës 29.05.2024.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 29.05.2024 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2554_05_24 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit, përmes së cilës e kishte kontestuar faturën e muajit 01/2024, në vlerë prej **637.87€**, për shkak të dyshimeve në lexim dhe faturim jo të saktë të njehsorit elektrik me nr. 87431594.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori **A.B** brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- Në muajin dhjetor 2023 dhe janar 2024, konsumatori pretendon që ka qenë jashtë vendit dhe se në atë shtëpi nuk jeton askush tjetër;
- Konsumatori kërkon që të rishqyrtohet vendimi i DMK-së, sepse pretendon që këtë shpenzim nuk e ka krijuar.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 01.07.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 12.06.2024; Vendimin e DMK të datës 29.05.2024; Ankesën e konsumatorit në KESCO të datës 22.01.2024; Përgjigjen e KESCO-s të datës 25.03.2024, Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 29.03.2024; Procesverbalin e inspektimit të dt. 22.09.2023; Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të dt. 22.09.2023; Rrjedhën e energjisë elektrike, Transaksionet dhe Listat e Leximit, si dhe korrigjimin financiar të dt. 08.02.2024.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 22.01.2024 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën janar 2024 me **5,505 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **637.87 €**. Me datë 22.01.2024 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kërkuar që t'i behet ri shqyrtimi i faturës për periudhën janar 2024, për shkak të dyshimit në matje, leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 87431594. Me datë 25.03.2024 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, transaksioneve si dhe listat e leximit si dhe me datë 08.02.2024 kanë bërë korrigjimin financiar, në vlerë prej **-46.34 €**.

Nga analizimi i shkresave të lëndës për këtë konsumator, Bordi ka gjetur se, me datë 22.09.2023, punëtorët e autorizuar të KEDS për inspektimin e pikës matëse, në procesverbalin me nr. 2099269, e kanë evidentuar këtë gjendje të njehsorit TL = 56347 kWh dhe TU = 82649 kWh dhe në vërejtje është evidentuar si vijon: “Me urdhëresë bëhet ndërrimi i njehsorit nga mekanik në digjital. Njehsori i vjetër merret për verifikim”.

Po ashtu, Bordi e ka analizuar me kujdes edhe Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik me nr. 0212539, të dt. 22.09.2023, në të cilin punëtorët e autorizuar të KEDS kanë evidentuar se ndërrohet/demontohet njehsori me nr. 17663052 me gjendje të shpenzimeve TL = 56347 kWh dhe TU = 82649 kWh dhe se për matje është vendosur/montuar njehsori i ri me nr. 84731549 me gjendje të shpenzimeve TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Në vërejtje të këtij procesverbali është evidentuar si vijon: “Bazuar në procesin me nr. 2099269 bëhet ndërrimi i njehsorit dhe njehsori i vjetër merret për verifikim”.

Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike si dhe listave të leximit, Bordi ka gjetur se, me njehsorin e vjetër elektrik me nr. 17663052, në pjesën me të madhe të periudhave kohore është evidentuar në lista të leximit si “Mungon pllomba”, njehsori nuk gjendet, njehsori brenda, diasporë, si dhe sugjerim për zhvendosje, që nënkupton që punëtorët e autorizuar të KEDS, nuk kanë pasur qasje në njehsorin elektrik. Një gjendje e tillë faktike, është në kundërshtim me nenin 25 – Qasja në pronë të konsumatorit – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si vijon: “Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të



Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testim, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji”. Pra, konsumatori ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore, sepse është dashur që të iu lejojë qasje në pikën matëse punëtorëve të autorizuar të KEDS. Më tej, Bordi ka analizuar shpenzimet e konsumatorit, dhe ka gjetur se, për disa periudha kohore të caktuara, ishte faturuar vetëm me taksa, ndërkaq, për disa periudha të tjera me shpenzime. Po ashtu, Bordi ka gjetur se, konsumatori në muajin dhjetor ishte faturuar vetëm me taksa, për shkak se punëtorët e autorizuar të KEDS-it nuk kanë pasur qasje në pikën matëse. Kësisoj, faturimi prej **5,505 kWh**, paraqet shpenzim për dy muaj dhe atë për muajin dhjetor 2023 dhe janar 2024, dhe nuk paraqet shpenzim real një muaj të konsumatorit. Një gjë e tillë është evidentuar edhe në vendimin e KESCO-s të kontestuar nga konsumatori. Në mënyrë që të kemi një pasqyrë të qartë të profilit të konsumatorit, Bordi ka analizuar edhe shpenzimet e tij, me njëhisorin e vjetër elektrik me nr. 17663052, dhe atë për periudhat si vijon: periudha **12/2022** është **5,406 kWh**, periudha **01/2023** është **4,659 kWh**, periudha **02/2023** është **5,854 kWh**, periudha **03/2023** është **3,589 kWh**, dhe periudha **04/2023** është **2,090 kWh**. Pra, nga sa mund të shihet nga ky krahasim, konsumatori ka pasur shpenzime të përafërta, si ato të periudhës kontestuese, edhe përgjatë vitit të kaluar.

Bordi më tej ka analizuar edhe korrigjimin financiar të dt. 08.02.2024, në vlerë prej **-46.34€** dhe ka gjetur se ky korrigjim si i tillë është i saktë dhe se konsumatorin nuk i takon korrigjim tjetër financiar. Po ashtu, edhe shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit dhe ndërrimit të njëhisorit elektrik të dt. 22.09.2023, përpunohen me gjendjen e shpenzimeve të evidentuara në CCP. Rrjedhimisht, KESCO-ja ka vepruar konform nenit 28 par. 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, e ku thuhet se: *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njëhisorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”.*

Tutje, Bordi thekson se, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuar nga ZRrE-ja”, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi po ashtu, i ka shqyrtuar me kujdes pretendimet e tjera ankimore, se konsumatori nuk ka qenë në shtëpi për këtë periudhë dhe se nuk e ka krijuar këtë shpenzim, dhe thekson se, energjia elektrike e faturuar është e regjistruar në njëhisor, që nënkupton që kjo energji është shpenzuar nga konsumatori, dhe rrjedhimisht, pretendimet e konsumatorit si të tilla nuk qëndrojnë. Po ashtu, duke e marrë parasysh faktin se, konsumatori i është ndërruar njëhisorin në shtator dhe i është vendosur për matje një njëhisor i ri, konsumatori ka shpenzime të përafërta edhe në periudhat e njëjta (dimrit) të vitit të kaluar, fatura e kontestuar paraqet grumbullim të shpenzimeve për dy muaj, dhe se është analizuar edhe korrigjimi dhe si i tillë ka rezultuar i saktë, Bordi ka vendosur që ta refuzoj si të pabazuar ankesën e konsumatorit, ashtu që në fuqi mbetet vendimi i kontestuar i DMK-së.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i



bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit: **A.B** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.